



NATASHA PAVIQEVIQ – STOJMENOVSKA
NIKOLINA NIKOLLOVSKA

DORACAK

PËR VAJZA DHE GRA ME INFORMACIONET E
NEVOJSHME PËR MUNDËSITË NË DISPOZICION
PËR MBËSHTETJE PËR VETËPUNËSIM OSE
FILLIMIN E BIZNESIT INDIVIDUAL

DORACAK

për vajza dhe gra me informacionet e nevojshme për mundësitë në dispozicion për mbështetje për vetëpunësim ose fillimin e biznesit individual

**SHOQATA PËR MUNDËSI TË BARABARTA RRJETI
„STELLA“, SHKUP**

AUTORE:
NATASHA PAVIQEVIC – STOJMENOVSKA
NIKOLINA NIKOLLOVSKA

REDAKTIMI GRAFIK:
TEANO KARDULLA

Ky projekt është i mbështetur me grant nga Ambasada e SHBA-ve. Mendimet, zbulimet dhe konkluzionet ose rekomandimet e paraqitura këtu janë të implementuesve/autorëve dhe nuk i reflektojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë së SHBA-ve.

PËRMBAJTJA

Hyrje	4
VETËPUNËSIMI – SIPËRMARRËSIA E GRAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË (KONCEPTI KUNDREJT GJENDJEVE DHE PERCEPTIMEVE)	6
Termat dhe përkufizimet në lidhje me vetëpunësimin dhe sipërmarrjen	7
Gjendjet dhe perceptimet për vetëpunësim dhe sipërmarrësi të vajzave dhe grave në Republikën e Maqedonisë	9
SHËRBIME DHE MBËSHTETJE SHTETËRORE OSE FORMALE PËR VAJZAT DHE GRATË PËR VETËPUNËSIM OSE FILLIMIN E BIZNESIT INDIVIDUAL	16
MBËSHTETJE PËR VETËPUNËSIM (SIPËRMARRËSI) - “Vetëpunësim me grant” (fonde të pakthyeshme për hapjen e biznesit individual)	21
Për kë është ose kush mund të përdorë masën aktive për punësim: Programi për Vetëpunësim (Sipërmarrje) me grant?	25
Cilët janë HAPAT për përfshirjen e suksesshme të kandidateve femra në masën aktive për punësim: Programi për Vetëpunësim (Sipërmarrje) me grant?	27
Cilat janë PËRFITIMET për vajzat dhe gratë nga masa aktive për punësim: Programi për Vetëpunësim (Sipërmarrje) me grant?	35
Cilat janë të DREJTAT dhe DETYRIMET e vajzave dhe grave në masën aktive për punësim: Programi për Vetëpunësim (Sipërmarrje) me grant?	36
MBËSHTETJE PËR VETËPUNËSIM (SIPËRMARRËSI) - “Vetëpunësim me grant” (fonde të pakthyeshme për hapjen e biznesit individual)	39
SHËRBIME DHE MBËSHTETJE JOQEVERITARE OSE JOFORMALE PËR VAJZAT DHE GRATË PËR VETËPUNËSIM OSE FILLIMIN E BIZNESIT INDIVIDUAL	43
SHTOJCAT	46
SHTOJCA NR. 1: Thirrje publike – Programi 1 Mbështetje për Vetëpunësim (Sipërmarrje)	47
SHTOJCA NR. 2: Deklaratë për pëlqim – Programi Vetëpunësim	50
SHTOJCA NR. 3: Kriteret për vlerësimin e një ideje biznesi (maksimumi 50 pikë)	51
SHTOJCA NR. 4: Informacion për zgjedhjen e një konsulenti nga APPRM për zhvillimin e një plani biznesi	56
SHTOJCA NR. 5: Kriteret për vlerësimin e një plani biznesi (maksimumi 50 pikë)	57
SHTOJCA NR. 6: Fletë informative për regjistrimin e subjektit juridik	60
SHTOJCA NR. 7: Kërkesë për dhënie kredie sipas projektit për Vetëpunësim me kredi (Formulari B/1)	61
SHTOJCA NR. 8: Kërkesë për dhënie kredie sipas projektit për Vetëpunësim me kredi (Formulari B/2)	62
BIBLIOGRAFIA DHE BURIMET	64

Hyrje

Gratë dhe vajzat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për fat të keq, ende përballen me pengesa dhe sfida të cilat vështirësojnë zhvillimin e sipërmarrjes së grave, por edhe zgjidhjen e problemeve në forcimin dhe mbarëvajtjen e saj. Perceptimi i mjedisit për përfshirjen e gruas në mjedisin e biznesit është i mbushur me stereotipe dhe qëndrime tradicionale për rolin e saj në shoqëri. Qasja në informacione për të gjitha aspektet e hapjes së një biznesi dhe mundësitë për fillimin dhe drejtimin e një biznesi, mbështetja për bizneset dhe kultura e pazhvilluar sipërmarrëse (mungesa e aftësive sipërmarrëse, marrja e rrezikut), mungesa e masave afirmative që do të mundësojnë stimulimin e aktivitetit ekonomik të grave, janë vetëm një pjesë e pengesave dhe sfidave të shumta me të cilat përballen gratë dhe vajzat gjatë vetëpunësimit dhe sipërmarrësisë.

Ky doracak është përgatitur për të lehtësuar qasjen e punëkërkueseve (gra dhe vajza) për të gjetur punë përmes vetëpunësimit, me zbatimin e informimit përkatës, lidhjen me shërbimet e duhura për ndihmë dhe mbështetje gjatë procesit/rrugës së punësimit nëpërmjet vetëpunësimit, por edhe motivimin e vajzave dhe grave gjatë atij procesi.

Më konkretisht, doracaku është një lloj udhërrëfyese për gratë dhe vajzat drejt mundësive për qasje në nivele më efektive dhe të përshtatshme të kujdesit dhe mbështetjes në procesin e punësimit nëpërmjet vetëpunësimit ose fillimit të biznesit individual. Përmbajtja e Doracakut përbëhet nga informacione të qarta dhe të sakta për procesin e vetëpunësimit dhe hapjes së biznesit individual nëpërmjet mundësive që ofrojnë institucionet qeveritare, shoqatat e qytetarëve dhe organizatat dhe institucionet e tjera, dhe përbëhet nga tre kapituj kryesorë:

1)

Vetëpunësimi – Sipërmarrësia e grave në Republikën e Maqedonisë (koncepti kundrejt kushteve dhe perceptimeve);

2)

Shërbime dhe mbështetje shtetërore ose formale për vajzat dhe gratë për vetëpunësim ose fillimin e biznesit individual dhe

3)

Shërbime dhe mbështetje joqeveritare ose joformale për vajzat dhe gratë për vetëpunësim ose fillimin e biznesit individual.

Në secilën pjesë janë dhënë përmbajtje konceptuale dhe përmbajtje të përpunuara analitike, të përpiluara me aplikimin e një qasje metodologjike cilësore dhe teknika të ndryshme:

Pasqyrë e gjendjes

Në këto përmbajtje konceptuale, në secilin nga kapitujt janë paraqitur gjetjet dhe analizat e përpiluara në bazë të zbatimit të teknikës analiza e përmbajtjes të të dhënave përkatëse dhe të disponueshme: ligje, akte nënligjore, të dhëna statistikore, raporte etj., lidhur me vetëpunësimin ose hapjen e biznesit individual në Republikën e Maqedonisë.



Udhëzime për vajzat dhe gratë

Bazuar në gjetjet nga aplikimi i mbledhjes së të dhënave dytësore dhe analizës së përmbajtjes, si dhe nga mbledhja e të dhënave parësore, përmes gjetjeve indikative nga fokus grupet e realizuara, janë përpiluar udhëzimet e qarta të mëposhtme për vajzat dhe gratë:

- Si të tejkalohen sfidat me të cilat përballeni gjatë vetëpunësimit ose fillimit të biznesin individual?
- Cilat janë hapat në realizimin e VETËPUNËSIMIT – grant i pakthyeshëm?
- Cilat janë hapat në arritjen e VETËPUNËSIMIT me kredi?



Çfarë thonë përvojat?

Këto përmbajtje konceptuale janë përpiluar në bazë të gjetjeve indikative nga diskutimet e zhvilluara në fokus grupet online, të mbështetura me citate të pjesëmarrëseve. Gjatë përgatitjes së këtij doracaku janë realizuar 4 (katër) fokus grupe:

- 1 (një) me Këshilltare për masa aktive për punësim, përfaqësuese - pjesëmarrëse nga tetë rajonet planore, nga një këshilltare nga qendrat për punësim nga Shkupi, Kumanova, Shtipi, Kavadari, Strumica, Tetova, Manastiri dhe Ohri - gjithsej 8 (tetë) këshilltare / pjesëmarrëse dhe
- 3 (tre) fokus grupe me tetë pjesëmarrëse-përfaqësuese nga çdo rajon planor në secilin grup, të ndara sipas strukturës së moshës: një me vajza dhe të reja (deri në 29 vjeç), një me gra dhe vajza të reja (deri në 39 vjeç) dhe një me gra (mbi 39 vjeç), të cilat janë punësuar përmes vetëpunësimit dhe kanë biznesin e tyre (gjithsej 24 gra dhe vajza). Në secilin fokus grup kishte nga një pjesëmarrëse nga qytetet në vijim: Shkupi, Kumanova, Shtipi, Kavadari, Strumicë, Tetova, Manastiri dhe Ohri.



Shpresojmë se Doracaku si mjet do të shërbejë si udhëzues hap pas hapi për vajzat dhe gratë në procesin e punësimit përmes masës për vetëpunësim, me udhëzime të lehta për t'u kuptuar, informuese dhe udhëzuese.

1

VETËPUNËSIMI

SIPËRMARRËSIA E GRAVE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË
(KONCEPTI KUNDREJT GJENDJEVE
DHE PERCEPTIMEVE)

Termat dhe përkufizimet në lidhje me vetëpunësimin dhe sipërmarrjen

Tema e vetëpunësimit dhe sipërmarrjes është prezente në shoqërinë tonë për një kohë të gjatë. Por kur bëhet fjalë për përcaktimin e saktë ose atë që nënkuptohet me vetëpunësim, sipërmarrësi, punëdhënës e kështu me radhë, hasim në pyetje nëse bëhet fjalë për terma të njëjtë apo të ngjashëm apo të ndryshëm.

Çfarë nënkuptohet me VETËPUNËSIM?

Përgjigja për këtë pyetje mund të gjendet në frazeologjinë e zhargonit që e dëgjojmë mjaft shpesh: “zot i vetes”. Një person i vetëpunësuar nuk punon për një punëdhënës të caktuar që i paguan atij/asaj kompensim ose pagë.

Cili person është PERSON I VETËPUNËSUAR?

Person i vetëpunësuar është personi fizik, i cili për llogari të tij kryen një veprimtari të pavarur ekonomike ose shërbime profesionale dhe shërbime të tjera intelektuale nga të cilat fiton të ardhura. Personat e vetëpunësuar punojnë për vete në zanate, profesione dhe veprimtari të ndryshme në vend që të punojnë për një punëdhënës. Në Bashkimin Evropian, personat e vetëpunësuar përkufizohen si “personat që ushtrojnë biznesin e tyre, praktikën profesionale ose fermën për qëllime fitimi dhe që nuk punësojnë persona të tjerë.”¹ Në Republikën e Maqedonisë e përdorim termin të punësuar për llogari të tyre; këta janë njerëz që kanë objektin e tyre të shitjes dhe punojnë në të, ndërkaq gjatë kësaj nuk punësojnë njerëz të tjerë.

1.1

¹ Eurofound. “Self-Employed Person.”, достапно на <https://www.eurofound.europa.eu/observatories/eur-work/industrial-relations-dictionary/self-employed-person>

Çfarë nënkuptohet me PUNËDHËNËS/E dhe çfarë me SIPËRMARRËS/E?

Punëdhënësi/ja është person juridik ose njësi organizative e tij që punëson punëtorë.

Sipërmarrës/e është një individ që krijon një biznes të ri individual. Procesi i themelimit të një biznesi njihet si sipërmarrësi. Sipërmarrësi/ja zakonisht shihet si një novator/e, si një burim idesh, mallrash, shërbimesh dhe biznesi/ose procedurash.

Sipërmarrësit luajnë një rol kryesor në çdo ekonomi, duke përdorur aftësitë dhe iniciativën e nevojshme për të parashikuar nevojat dhe për të sjellë ide të reja të mira në treg.

Këto terma të përcaktuara thjesht na japin një ide më të qartë për ta dhe rëndësinë e tyre.

Gjendjet dhe perceptimet për vetëpunësim dhe sipërmarrësi të vajzave dhe grave në Republikën e Maqedonisë

Pasqyrë e gjendjes



Siç thuhet në publikimin “Gratë sipërmarrëse në Maqedoninë e Veriut: Perceptimet dhe pengesat”² Maqedonia e Veriut ka një shkallë të lartë papunësie, ndërkaq veçanërisht gratë kanë një pjesëmarrje shumë të ulët në tregun e punës, pasivitet të lartë ekonomik dhe papajtueshmëri ndërmjet profileve të punës në dispozicion dhe profileve të kërkuara për vende të lira pune. Në kontekstin e vetëpunësimit dhe sipërmarrjes, ofrojmë një pasqyrë të shkurtër të gjendjes ekonomike të vajzave dhe grave gjatë pesë viteve të fundit, duke përfshirë dy vitet e fundit të pandemisë (nga viti 2017 deri në vitin 2021). Këtë e konsiderojmë të rëndësishme nga aspekti i kuptimit të gjendjes reale me përfshirjen e vajzave dhe grave në tregun e punës, bazuar në prova. Pa hyrë në një analizë të detajuar, duke qenë se nuk është ky qëllimi i këtij publikimi, veçojmë vetëm disa tregues kryesorë që janë të rëndësishëm në përshkrimin e situatës, por edhe tendencat në përfshirjen e vajzave dhe grave si sipërmarrëse dhe të vetë-punësuar.


- Vetëpunësimi dhe sipërmarrja ende njihen si mundësi për punësim dhe për të fituar të ardhura dhe paga nga një numër i vogël i burrave dhe grave në tregun e punës (rreth 5% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve sipas gjendjes ekonomike); numri i të punësuarve të një punëdhënësi tjetër paraqitet në pjesën më të madhe të numrit të përgjithshëm të burrave dhe grave të punësuar (mbi 85%) gjatë pesë viteve të përcaktuara.
- Gratë nga zonat urbane paraqiten si punëdhënëse me një përqindje prej 23 deri në 30% (nga pothuajse një e katërta deri në afërsisht një e treta) të numrit të përgjithshëm të punëdhënësve, ndërsa kjo përqindje tek gratë nga zonat rurale është dukshëm më e ulët dhe ndryshon nga 10 në 16% nga numri i përgjithshëm i punëdhënësve. (shih Grafikun 1 dhe 2)

1.2

² „Gratë sipërmarrëse në Maqedoninë e Veriut: Perceptimet dhe pengesat” (2020), Shoqata për Mundësi të Barabarta - Rrjeti Stella, Shkup, në dispozicion në <https://stella.mk/wp-content/uploads/2021/03/PP-MK-Final.pdf>

Grafiku 1


Të punësuar sipas statusit ekonomik dhe gjinisë (%) zona rurale, sipas viteve



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, Baza e të Dhënave MakStat - Tregu i Punës

Grafiku 2

Punonjësit sipas gjendjes ekonomike dhe gjinisë (%) zona rurale, sipas viteve




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, Baza e të Dhënave MakStat - Tregu i Punës

- Trendi i punëdhënësive, i cili nga viti 2017 në 2019 tregon rritje, nga viti 2019 në 2021 tregon një rënie prej 7.5 pikë të përqindjes të gratë (Grafiku nr.3).

Grafiku 3

Struktura e statusit ekonomik Punëdhënës/e sipas gjinisë në %




Извор: Државен завод за статистика, База на податоци МакСтат – Пазар на труд

- Trendi i grave të vetëpunësuar tregon një rritje konstante deri në vitin 2020 nga 18,4% në 24.4%, por në vitin 2021 bie me 1,8 pikë të përqindjes (Grafiku 4).

Grafiku 4

Struktura e statusit ekonomik I/e vetëpunësuar sipas gjinisë në %



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave, Baza e të Dhënave MakStat - Tregu i Punës

Udhëzime për vajzat dhe gratë - Si të kapërceni sfidat me të cilat përballeni kur jeni të vetëpunësuar ose filloni biznesin tuaj?



Si sfidat më të theksuara dhe më të pranishme me të cilat përballen gratë sipërmarrëse, veçojmë si më poshtë:

1. Tejkalmimi i stigmave sociale.
2. Tejkalmimi i frikës nga dështimi.
3. Balancimi i përgjegjësiwe të punës me familjen.

1) Tejkalmimi i stigmave sociale

Normat shoqërore na mësojnë të presim modele të caktuara të sjelljes nga burrat dhe sjellje të ndryshme nga gratë. Por në botën e biznesit, pavarësisht nga gjinia, sipërmarrja kërkon një nivel të lartë konkurrence. Me fjalë të tjera, bota e biznesit kërkon tipare që janë të kundërta me tiparet e përshkruara nga normat shoqërore për gratë: të jenë të qeta, të buta dhe të kenë pritshmëri minimale nga vetja dhe arritjet e tyre.

Si ta kapërceni këtë sfidë:

Si ta kapërceni këtë sfidë:

Kini vetëbesim dhe dëshmoni veten (si para vetes tuaj dhe para të tjerëve)! Mos lejoni që pritshmëritë e të tjerëve T'ju rëndojnë dhe T'ju pengojnë të arrini dhe të tregoni potencialin tuaj të plotë. Suksesi në realizimin e vetëpunësimit dhe biznesit është i domosdoshëm pavarësisht gjinisë (nuk varet nga gjinia, por nga vizioni, aftësitë, vetëbesimi dhe këmbëngulja)!
Si ta kapërceni këtë sfidë: Si ta kapërceni këtë sfidë:

2) Tejkalmimi i frikës nga dështimi

Është krejtësisht normale që pronarët e bizneseve dhe të vetëpunësuarit të përjetojnë ankth dhe frikë përballë dështimit të mundshëm dhe/ose real, për të cilat dy vitet e fundit të pandemisë me Kovid-19 kanë qenë një përvojë e mirë. Gjëja më e rëndësishme është të mos lejoni që ajo frikë të dominojë aftësinë tuaj për të pasur sukses dhe aftësitë profesionale.

Si ta kapërceni këtë sfidë:

Mësoni mësim nga të tjerët; shikoni statistikën për të ashtuquajturat dështime të bizneseve të vogla; mësoni cilat janë shkaqet e zakonshme të dështimit dhe strategjitë më të mira për parashikimin e tyre dhe shmanjen e dështimeve të mundshme. E vetmja gjë nga e cila duhet të kemi frikë, është vetë frika! Zgjidhja nuk është të injorohet frika, por të identifikohet kur ka arsye legjitime për frikën dhe të ndërmerren hapat e nevojshëm për të hequr ato pengesa.

3) Balancimi i përgjegjësisë të punës me familjen

Kjo është një nga sfidat më të zakonshme me të cilat përballen të gjitha gratë e përfshira në tregun e punës. Si mund ta kuptojmë dhe ta realizojmë në mënyrë adekuate rolin e prindit ndërkohë që jemi edhe të punësuar, të vetëpunësuar apo kemi biznesin tonë?

Si ta kapërceni këtë sfidë:

Edhe pse shanset nuk janë të barabarta në krahasim me meshkujt, kjo në asnjë mënyrë nuk e bën suksesin e biznesit një objektiv të paarritshëm për nënat. Përkundrazi! Të jesh prind do të thotë se kemi zhvilluar aftësi për të ashtuquajturën multi-tasking (për të përmbushur disa detyrime në të njëjtën kohë); ndërsa kjo është një vlerë e shtuar për çdo person të vetëpunësuar, përkatësisht vajzë apo grua me biznes individual.

Për më tepër, veçojmë dy sfidat e mëposhtme me të cilat përballen vajzat dhe gratë kur vetëpunësohen ose fillojnë biznesin e tyre, të cilat i paraqesim më në detaje si kapituj të veçantë në vazhdim të këtij doracaku:

- 4) Rrjetëzimi dhe lidhja me burime formale dhe joformale të mbështetjes.
- 5) Qasja në burime (të qëndrueshme) të financimit.



Çfarë thonë përvojat?

Nga diskutimet në fokus grupet dolën gjetje që tregojnë se motivet kryesore për vajzat dhe gratë që kanë vendosur të vetëpunësohen dhe të fillojnë biznesin e tyre janë:

1. kërkimi i punës,
2. vizioni dhe ideja e qartë për biznes individual, por edhe
3. mungesa dhe/ose tejkalimi i sfidave të mësipërme.

99

Një grua sipërmarrëse ka vizion më të madh dhe është organizatore e aktiviteteve dhe e punës si në shtëpi, ashtu edhe në vendin e punës dhe në biznesin e saj

Pronare e biznesit individual
që nga viti 2021
30 vjet

99

Ndërgjegjësimi i popullatës femërore tashmë është në një nivel më të lartë; gjithnjë e më shumë gra janë të guximshme dhe të inkurajuara për të filluar biznes individual.

Këshilltare për masa aktive për
punësim në APRM-Qendra
për punësim

99

Ngela pa punë në fillim të pandemisë. Por sipas profesionit më duhej një zgjidhje në plan afatgjatë, kushte më të mira pune, pagë më e lartë... Rrethanat janë gjithmonë të vështira, por siç është përshtatur e gjithë bota, kështu jam përshtatur edhe unë...

E vetëpunësuar që nga viti 2021
37 vjeç

99

Një vajzë e re, me arsim të lartë nga Ohri, më e re se 29 vjeç, punonte në një dyqan lulesh në Shkup. Aty ka fituar aftësitë dhe, siç thonë në gjuhën e popullit, “ka mësuar biznesin” dhe u inkurajua të aplikonte për biznesin e saj në atë fushë. Aktualisht ka paraqitur aplikim dhe është duke punuar në plan biznesi që besoj se do të miratohet...

Këshilltare për masa aktive
për punësim në APRM-Qendra
për punësim

2

**SHËRBIME DHE
MBËSHTETJE SHTETËRORE
OSE FORMALE PËR
VAJZAT DHE GRATË PËR
VETËPUNËSIM OSE
FILLIMIN E BIZNESIT
INDIVIDUAL**

Siç u përmend më herët, sfida shtesë me të cilat përballen vajzat dhe gratë gjatë vetëpunësimit ose fillimit të biznesit të tyre, janë:

- **Rrjetëzimi dhe lidhja me burime formale dhe joformale të mbështetjes.**
- **Qasja në burime (të qëndrueshme) të financimit.**

Këto dy sfida janë të ndërlidhura, përkatësisht kur flasim për mbështetje sigurisht nënkuptojmë mbështetjen financiare për vetëpunësim dhe fillimin e biznesit individual. Në Republikën e Maqedonisë, kur themi “shërbime formale për mbështetje” nënkuptojmë shërbimet e ofruara nga shteti, gjegjësisht të cilat janë pjesë e politikave³, strategjive, programeve dhe masave për punësim dhe uljen e papunësisë në vend. Në këtë kontekst, në nivel vjetor, sipas kushteve të tregut të punës⁴ shteti miraton **Plan operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës; ky dokument për vitin aktual 2022 gjendet në linkun e mëposhtëm: <https://av.gov.mk/content/pdf/FINALEN%20OP%202022.pdf>.**

Në fokusin e Planit Operativ është përfaqësimi i barabartë i burrave dhe grave, në përputhje me Ligjin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, pjesëmarrja e të rinjve deri në 29 vjeç të paktën 30%, si dhe personat me aftësi të kufizuara të cilët përfaqësohen pothuajse në të gjitha masat e punësimit.

Bartës i Planit Operativ është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale - MPPS. Zbatimi i Planit Operativ për programet aktive për masa për punësim dhe shërbime në tregun e punës është në kompetencë të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut - APRMV, Shkup në partneritet me institucionet tjera përgjegjëse.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

<https://www.mtsp.gov.mk/>



Република Северна Македонија
Министерство за труд
и социјална политика

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale - MPPS⁵, si kompetencë të parë ka marrëdhëniet e punës, punësimin dhe nivelin e punësimit; është bartës i politikave dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me këtë kompetencë, përfshirë Planin Operativ për programet dhe masat aktive për punësimin dhe shërbimet në tregun e punës në nivel vjetor.

³Korniza e politikave për punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut është përcaktuar me Programin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Programin e rishikuar për reforma në punësim dhe politikë sociale 2022, dhe është në përputhje me obligimet që dalin nga Pakti Global për vende pune i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (MOT), Plani për Garanci Rinore 2020-2022, Programi për Financim Buxhetor IPA, reformat në sistemin e mbrojtjes sociale dhe vendosja e asistencës minimale të garantuar.

⁴Tregu i punës – treg në të cilin personat që kërkojnë punë dhe posedojnë njohuri, shkathtësi dhe përvojë pune takohen me punëdhënësit që kërkojnë kandidatë për vende të lira pune ose lloje të caktuara të punës për një kompensim të caktuar monetar (pagë) të cilët do të bihet dakord reciprokisht.

⁵<https://www.mtsp.gov.mk/misija.nspix>

**Agjencia e Punësimit e
RMV-së (APRMV)**<https://av.gov.mk/>**АГЕНЦИЈА ЗА ВРАБОТУВАЊЕ
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut është institucion publik që kryen punë profesionale, organizative, administrative dhe punë të tjera lidhur me punësimin dhe sigurimin në rast të papunësisë dhe ofron mbështetje, ndihmë dhe shërbime për pjesëmarrësit në tregun e punës. Selia e Agjencisë është në Shkup.

Agjencia e punësimit, nëpërmjet qendrave të punësimit, ndërmjetëson punësimin. Ajo vendos lidhje midis vendeve të lira të punës te punëdhënësit (nevoja për fuqi punëtore) dhe punëkërkuësve. Ky institucion është drejtpërdrejt bartës dhe zbatues i Planit Operativ për programet dhe masat aktive për punësimin dhe shërbimet në tregun e punës, i cili miratohet dhe zbatohet në nivel vjetor. Qendra për punësim (30 Qendrat për punësim– lista e kontakteve) <http://av.gov.mk/centri-za-vrabotuvanje.nsp>

**Agjencia për Mbështetjen e
Sipërmarrësisë e Republikës
së Maqedonisë së Veriut
(AMSRMV)**
<http://apprm.gov.mk/Home>
<https://www.facebook.com/aprmak>
**АГЕНЦИЈА ЗА ПОДДРШКА НА
ПРЕТПРИЕМНИШТВОТО НА
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut (AMSRMV) është institucion shtetëror i themeluar me qëllim të zbatimit të politikave të Qeverisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe projekte/programme të tjera të ndërlidhura të miratuara nga Qeveria për mbështetjen e sipërmarrësisë, konkurrencës dhe inovacionit.

Agjencia, duke pasur rolin e ndërmjetësit ndërmjet politikë bërësve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, mban partneritet të ngushtë dhe komunikim të vazhdueshëm me të gjitha institucionet që merren me promovimin e sipërmarrjes dhe mbështetjen e MPS-ve. Agjencia ofron mbështetje këshillimore përmes Sistemit të bonove për këshillim të AMSRMV, për të cilin ekziston një Program i përgatitur posaçërisht, i qasshëm në linkun e mëposhtëm: file:///C:/Users/Com/Downloads/PROGRAMA%20za%20vaucersko%20sovetuvanje_REZIME.pdf

UNDP Maqedoni<https://www.undp.org/north-macedonia><https://mk-mk.facebook.com/UNDPMK/>

Përfshirja e kësaj organizate ndërkombëtare në realizimin e masës për vetëpunësim për vitin 2022 konsiston në 9 (nëntë) biznese të reja të mbështetura përmes projektit rajonal të UNDP-së, për personat që janë kthyer nga jashtë shtetit, anëtarë të komunitetit rom dhe persona të tjerë në rrezik social dhe përjashtim ekonomik do të formohen në këto komuna të përzgjedhura: Shuto Orizar, Shtip dhe Prilep.

UNDP gjithashtu zbaton Programin për Vetëpunësim për personat me aftësi të kufizuara në të cilin personat me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar kanë të drejtë të aplikojnë. Gjatë këtij procesi, aplikantët/et kalojnë vlerësim funksional të kapaciteteve të tyre, i cili kryhet nga ekspertë. Gjatë këtij procesi aplikantët/et kalojnë edhe trajnime për sipërmarrje dhe zhvillim të biznes ideve, gjë që i ndihmon më tej në procesin e formimit të biznesit të tyre.

**Shoqata Nisma për
Zhvillim Ekonomik të
Romëve REDI**
<https://redi-ngo.eu/><https://www.facebook.com/REDIMACEDONIA/>

Nisma për zhvillimin ekonomik të romëve - REDI do të zbatojë një program E-akselerator që synon transferimin e njohurive dhe aftësive për 50 biznese të menaxhuara nga romët për shndërrimin e tyre nga një biznes tradicional në një biznes digjital. Objektivat e trajnimit janë:

1. T'u mundësohet 50 bizneseve të menaxhuara nga romët nga Maqedonia e Veriut të përdorin punën e mençur SMART-in (SMART working) duke punuar në biznesin e tyre përmes qasjes në mjetet online dhe trajnim për biznes digjital;
2. Për të forcuar aftësitë e planifikimit të biznesit, planifikimit financiar dhe menaxhimit të biznesit të 50 romëve nga Maqedonia e Veriut
3. Transformim digjital i 50 bizneseve (formale apo informale) të menaxhuara nga romët;
4. Krijimi i 50 planeve të biznesit.


Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik - FIZhT

<https://www.facebook.com/fondzainovacii>
<https://ftr.mk/>



Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik është një institucion udhëheqës qeveritar për mbështetjen e startup-eve dhe kompanive inovative në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik u krijua me qëllim të nxitjes së inovacionit, duke ofruar burime plotësuese për financimin e inovacionit, për shkak të nevojës për të ndërtuar ekonomi konkurruese të bazuar në njohuri. Prioritetet kryesore të Fondit janë përmirësimi i qasjes në mbështetje financiare për inovacion dhe zhvillim teknologjik dhe promovimi dhe inkurajimi i aktivitetit inovativ në Maqedoninë e Veriut

Pjesë përbërëse e Planit Operativ për programe aktive, masa për punësim dhe shërbime në tregun e punës, është Programi MBËSHTETJE PËR VETËPUNËSIM (SIPËRMARRËSI). Programi është krijuar si bazë për mbështetje formale për të papunët, për të filluar biznesin e tyre, njëkohësisht ofron burime financimi në dy mënyra:



MBËSHTETJE PËR VETËPUNËSIM (SIPËRMARRËSI) - - “Vetëpunësim me grant” (fonde të pakthyeshme për hapjen e biznesit individual)

Programi për vetëpunësim - Vetëpunësim me grant është pjesë e Planit Operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2022 (Plani Operativ për programet aktive dhe masat për punësim dhe shërbime në tregun e punës, mars 2022⁶).

- **Qëllimi i kësaj mase**, e cila parashikohet në nivel vjetor, është të ofrojë mbështetje për personat e papunë të regjistruar në APRM-së, të fillojnë biznesin e tyre dhe formalizimin e veprimtarisë tashmë ekzistuese (joformale).
- **Mbeshtetja financiare** konsiston në sigurimin e fondeve të pakthyeshme për këta persona për të hapur biznesin e tyre - fonde të pakthyeshme (grant) në shumën prej 307.500 denarë për përdorues ose deri në 615.000 denarë nëse një person juridik është themeluar nga dy ortakë si një SHPK - shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me dy persona, ku secili prej ortakëve do të ketë pjesë të barabartë (50%) në shoqëri (mënyra e regjistrimit të SHPKNJ-ve dhe SHPK-ve përshkruhet në detaje më poshtë).
- **Fushëveprimi** i masës për vitin 2022 është 2000 persona të punësuar në persona juridikë të sapo-themeluar dhe 10 persona të tjerë do të punësohen nga punëdhënësit nga bizneset e sapo-themeluara në pronësi të personave me aftësi të kufizuar.

Në momentin e shkrimit të Doracakut, kjo masë është duke u zbatuar, në përputhje me thirrjen publike për të publikuar më 5 prill 2022 (shih Shtojcën nr.1).

⁶ <https://av.gov.mk/content/pdf/FINALEN%20OP%202022.pdf>

Në vijim, ofrojmë një pasqyrë të gjendjes së zbatimit të Programit për Vetëpunësim - Vetëpunësim me grant vitin e kaluar 2021, për sa i përket numrit të aplikimeve, zgjedhjes së planeve të biznesit dhe përfaqësimit të vajzave dhe grave në këtë masë. (Burimi: APRMV, Shkup në dispozicion në <https://av.gov.mk/content/pdf/ZA%20WEB%20-SAMO-VRABOTUVANJE%202021%20RANG%20LISTA%20ZA%20GRANT.pdf>)

Pasqyrë e gjendjes




Në Planin Operativ për programet dhe masat aktive për punësimin dhe shërbimet në tregun e punës për vitin 2021 (versioni i rishikuar i shtatorit 2021⁷), në Programin për Mbështetjen e Vetëpunësimit (Sipërmarrje) masa parashikohet të përfshijë 1877 persona të punësuar në persona juridikë të sapoformuar. Sipas të dhënave nga ranglista përfundimtare e publikuar e personave për grant (OP 2021 Masa 1) Përkrahja për Vetëpunësim (sipërmarrësi) nga APRMV, Shkup, kanë aplikuar gjithsej 1 578 persona, nga të cilët 800 ose 50.70% janë meshkuj dhe 778 ose 49.30% gra - një përqindje pothuajse e barabartë e aplikantëve meshkuj dhe femra në nivel nacional.

Në nivel rajonal (shih grafikun 5) mund të vërehet një ndryshim domethënës në raportin e aplikimeve midis burrave dhe grave, në favor të grave në rajonin planor të Pollogut (39.17% burra dhe 60.83% gra), rajonin planor të Pellagonisë (41.95% meshkuj dhe 58.05% femra) dhe me gati 5 pikë të përqindjes

Grafiku 5

Pasqyrë e numrit të aplikantëve për masën e vetëpunësimit 2021 sipas gjinisë, të shpërndarë sipas rajoneve planore %




⁷ Plani operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2021 <https://av.gov.mk/content/pdf/%D0%A0%D0%B5%D0%B2%D0%B8%D0%B4%D0%B8%D1%80%D0%B0%D0%BD%20%D0%9E%D0%9F-2021%20%D0%B3%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D0%BD%D0%B0%20%20USVOEN%20NA%20VLADA%20NA%2016.11%202021.pdf>

dallim më shumë aplikante femra paraqiten në rajonin planor Lindor dhe Jugperëndimor. Vetëm në rajonin planor juglindor (60.69% meshkuj dhe 39.31% femra) dhe në rajonin planor verilindor (58.61% dhe 41.39%) meshkujt aplikojnë për këtë masë në përqindje më të lartë. Në rajonin planor të Shkupit, shpërndarja e aplikantëve sipas gjinisë është pothuajse e barabartë (50.91% meshkuj dhe 49.09% femra), me vetëm 1.82% më shumë për aplikantët meshkuj.

Sa i përket shpërndarjes së numrit të aplikimeve për masën e Vetëpunësimit në vitin 2021, mund të thuhet se numri më i madh i aplikimeve ose gati një e pesta (302 ose 19%) janë në rajonin planor verilindor, ndërsa më së paku (145 ose 9%) në rajonin e rajonit planor Juglindor (shih Grafikun 6). Gjatë përzgjedhjes përfundimtare të aplikantëve, si kriter merret parimi i diversitetit dhe përfaqësimi i barabartë rajonal, me qëllim të kontribuohet në zhvillimin e barabartë ekonomik të të tetë rajoneve planore në RMV.

Grafiku 6


Paraqitje e numrit të aplikimeve për masën vetëpunësim 2021 - shpërndarja sipas rajoneve %



Nga numri i përgjithshëm i aplikimeve (1578), janë miratuar 1545 ose 97.91% e aplikimeve. 33 aplikimet të tjera (2.09%) ose u refuzuan për shkak të pikëve të fituara të pamjaftueshme - 14, nga të cilët 4 aplikantë të refuzuar janë burra dhe 10 gra (shih grafikun 7) ose kanë hequr dorë pas hartimit të planit të biznesit - 19, nga të cilët 11 ishin burra dhe 8 gra (shih grafikun 8).

Grafiku 7


Paraqitja e numrit të kërkesave të refuzuara për masën vetëpunësim 2021, sipas gjinisë %



мажи жени

Grafiku 8

Paraqitje e numrit të aplikantëve që kanë hequr dorë nga masa vetëpunësim 2021, sipas gjinisë %



мажи жени

Udhëzime për vajzat dhe gratë - Cilat janë hapat për realizimin e VETËPUNËSIMIT - grant i pakthyesëm?

Pasi të kemi përcaktuar masën, qëllimet, shtrirjen dhe pasqyrën e gjendjes në lidhje me aplikimin dhe përdorimin e masës së vetëpunësim vitin e kaluar, mund të japim udhëzime në lidhje me **grupin e synuar, hapat për përfshirjen e kandidatëve në masën dhe përfitimet, por dhe të drejtat dhe detyrimet e vajzave dhe grave nga masa Vetëpunësim me grant.**



Për kë është ose kush mund të përdorë masën aktive për punësim: Programi për Vetëpunësim (Sipërmarrje) me grant?

Target grupi për përdorimin e masës aktive për punësim Mbështetje për vetëpunësim (sipërmarrësi) janë personat e papunë të regjistruar në Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë - APRM. Masa Mbështetje për vetëpunësim (sipërmarrje) është në dispozicion të barabartë për burrat dhe gratë.

1. Vajzat dhe gra të reja të papuna deri në 29 vjeç

2. Vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara të papuna

3. Gra të papuna deri në 58 vjeç

4. Gra-viktima të dhunës me bazë gjinore dhe viktima të dhunës në familje

5. Gra të papuna që duan të formalizojnë biznesin e tyre - deri në 58 vjeç

6. Gra rome të papuna deri në 58 vjeç

7. Gra të papuna për shkak të korona virusit - deri në 58 vjeç

8. Gra të papuna që janë kthyer nga jashtë shteti deri në 58 vjeç

1. Djem të rinj të papunësuar dhe burra deri në 29 vjeç

2. Djem dhe burra me aftësi të kufizuara të papunë

3. Burra të papunë deri në 60 vjeç

4. Burra të papunë që duan të formalizojnë biznesin e tyre - deri në 60 vjeç

5. Romë të papunë - deri në 60 vjeç

6. Burra të papunë për shkak të korona virusit - deri në 60 vjeç

7. Burra të papunë që janë kthyer nga jashtë shteti - deri në 60 vjeç



Megjithatë, në Udhëzimet e operative për zbatimin e Planit Operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2022 vihet re se “ndonëse masa është krijuar si për burrat ashtu edhe për gratë, megjithatë për shkak të shkallës së ulët të punësimit të grave (38% në 2020) krahasuar me shkallën e punësimit të burrave (56% në 2020), raporti mashkull-femër gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për përgatitjen e një plani biznesi do të jetë 40:60, që krijon një qasje afirmative plotësuese në mbështetje të zvogëlimit të hendekut ndërmjet punësimit të burrave dhe grave në tregun e punës (kjo është pjesë e Angazhimeve të Qeverisë në Programin 20-24: Krijimi i politikave dhe masave për punësim që do të ndikojnë mbi uljen e mos-aktivitetit të grave në tregun e punës).

Çfarë thonë përvojat?



Për sa i përket qasjes ndaj masës së Vetëpunësimit si grupe të synuara, pjesëmarrësit më të rinj (deri në 29 vjeç) ndanë kryesisht një mendim bazuar në përvojën e tyre se kandidatët që kanë njohuri paraprake dhe frymë konkurruese kanë përparësi në përdorimin e masës, por gjithashtu edhe kandidatë që “janë më të moshuar” dhe “kanë një biznes informal”.



Unë hoqa dorë sepse nevojitet inkurajim, njohuri paraprake dhe frymë sipërmarrëse për të marrë pjesë në masën... ndërkajmë mendoj se në Qendrën për Punësim kanë pasur përparësi kandidatët më të moshuar, veçanërisht nëse kanë një biznes joformal ose zanat...

Aplikante në Masën
Vetëpunësim 2021,
26 vjeç



Është e rëndësishme që vajzat dhe gratë të dinë përpara se të aplikojnë për Masën e Vetëpunësimit se masa është e ‘përshtatur’ që t’i përgjigjet të gjithë grupit të synuar... më e rëndësishmja është dëshira dhe ideja e biznesit, ose është një avantazh nëse kandidatët tashmë kanë një biznes informal ose merren joformalisht me ndonjë zanat...”

Këshilltare për masa aktive për punësim në
APRM-Qendra për punësim

Cilët janë HAPAT për përfshirjen e suksesshme të kandidateve femra në masën aktive për punësim: Programi për Vetëpunësim (Sipërmarrje) me grant?

Për t'iu qasur me sukses masës aktive për punësim: Programi për Vetëpunësim (Sipërmarrje) me grant, duhet të kaloni hapat e mëposhtëm:

Hapi 1

**Kam biznes ide dhe dua ta realizoj
ose Kam zhvilluar biznes informal dhe dua ta formalizoj**

Mund të aplikoni për masën nëse keni ide biznesi për çdo fushë përveç këtyre pak veprimtarive (përmes programit nuk do të mbështetet themelimi i bizneseve në veprimtaritë si më poshtë):

1. Veprimtari bujqësore, përkatësisht veprimtari - Prodhimtari bimorë dhe shtazore, gjueti dhe veprimtari shërbyese që lidhen me to, me përjashtim të prodhimit bujqësor organik;
2. Bizneset në veprimtaritë- Shërbim taksi;
3. Prodhimi dhe shpërndarja e armëve;
4. Prodhimi i armëve dhe municionit;
5. Bizneset financiare dhe të sigurimit dhe aktivitetet që përfshijnë lojërat e fatit – Aktivitete financiare dhe sigurime.

Me përjashtim të Pikës 1 dhe 2, personat e papunë me aftësi të kufizuara, përfituesit e asistencës minimale të garantuar, personat që kanë humbur punën për shkak të Covid-19 (që nga marsi 2020) dhe personat romë të papunë do të mund të regjistrojnë subjekt juridik në veprimtaritë bujqësi dhe shërbim taksi.

Hapi 2

Thirrje publike / Njoftim

Thirrja publike publikohet në ueb-faqet zyrtare të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale. (www.avrm.gov.mk; www.mtsp.gov.mk, si dhe në faqen e specializuar të internetit www.rabotaimoznosti.mk). Gjithashtu, shpallja në formë të shkruar mund të gjendet në tabelat e shpalljeve në 30 qendrat e punësimit të APRM-së në gjithë Republikën e Maqedonisë, si dhe në vende të tjera përkatëse nëpër institucionet në nivel lokal (komuna, QPS dhe vende të tjera që frekuentohen më shumë).

Shpallja është e vazhdueshme/e hapur gjatë gjithë vitit, deri në plotësimin e numrit të parashikuar të aplikantëve sipas Planit Operativ për masat aktive dhe programet e punësimit për vitin 2022. Shpallja publike për masën Vetëpunësim, 2022 është publikuar më 5 prill 2022 (shih Shtojcën 1).

Hapi 3

Regjistrimi dhe plotësimi i pyetësorit të aplikimit

Regjistrimi i vajzave dhe grave për përfshirje në masën për Vetëpunësim mund të bëhet drejtpërdrejt në një nga Qendrat e Punësimit ku ato janë të evidentuara si të papuna ose online.

REGJISTRIM në Qendrat e Punësimit:

- Në Qendrën e Punësimit, ku vajzat dhe gratë janë të evidentuara si të papuna, aplikojnë kandidatet e interesuara – për pjesëmarrje në programin Vetëpunësim (gjithsej 30 qendra në të gjithë vendin).
- Lista e 30 qendrave për punësim të APRM: <http://avrm.gov.mk/centri-za-vrabotuvanje.nsp>

Online:

- E njëjta procedurë mund të bëhet online, sipas udhëzimeve të mëposhtme:
- https://e-rabota.av.gov.mk/Upatstvo/AVRM_Upatstvo_e_Rabota.pdf
- https://www.facebook.com/100077753190307/videos/5395595517145289/?extid=CL-UNK-UNK-UNK-AN_GK0T-GK1C-GK2C

Pas plotësimit të formularit, plotësohet i ashtuquajti Pyetësi për Aplikim ose Pyetësi për Vlerësimin e Afinitetit Sipërmarrës. Pyetësi për aplikim është i përbërë nga tre pjesë - grupe pyetjesh.

Grupi I i pyetjeve mbart maksimumi 25 pikë dhe mbulon aftësitë dhe shkathtësitë personale të pjesëmarrësve;

Grupi II përfshin pyetje për të dalluar ata kandidatë që janë të angazhuar në mënyrë joformale në biznes ose kanë pasur përvojë të mëparshme në drejtimin e një biznesi dhe kjo pjesë përmban maksimum 20 pikë; dhe

Grupi III i pyetjeve mbart maksimumi 45 pikë dhe i referohet njohurive të përgjithshme në fushën e sipërmarrjes.

Hapi 4**Plotësimi dhe nënshkrimi i
Deklaratës për pëlqim**

Hapi tjetër është plotësimi dhe nënshkrimi i dokumentit zyrtar të titulluar Deklaratë për pëlqim (shih Aneksin 2), në të cilin tregohen saktësisht veprimtaritë në të cilat kandidatet duhet të marrin pjesë, si dhe detyrimet me të cilat obligohen me përfshirjen në masën, përmes nënshkrimit të kësaj Deklarate.

Hapi 5**Pjesëmarrja në trajnime për sipërmarrje dhe
menaxhim biznesi** (koha e përpunimit: 30 orë trajnim
të realizuara në 4 ditë pune)

Trajnimi zhvillohet në klubet e punës të qendrave të punësimit, nga një agjenci e jashtme konsulente.

Pas përfundimit të çdo trajnimi (në fund të javës së punës) në një qendër punësimi, bëhet vlerësimi i kandidatëve që kanë paraqitur përshkrimin e një biznes ideje. Vlerësimi kryhet nga ekipi i konsulentëve/ligjëruesve dhe koordinatorëve të punësuar në qendrën e punësimit, sipas kritereve dhe dinamikave të përcaktuara paraprakisht. Kandidatët të ranguar më mirë, nga çdo javë pune në vazhdimësi udhëzohen të marrin pjesë në hapin e radhës përmes të cilit ofrohet asistencë shtesë këshilluese nga këshilltarët e AMSRM për zhvillimin e biznes planit.

Grupi punues i përbërë nga përfaqësues të shërbimit qendror të APRMV-së (sektori për masa aktive dhe shërbime të punësimit), MPPS, AMSRM dhe UNDP aprovonë rang listën e propozuar dhe për këtë nënshkruhet procesverbal i mbledhjes së mbajtur të Grupit të punës. Në këtë fazë, kandidatët nuk kanë të drejtë të paraqesin kundërshtim.

<http://tis.cov.gov.mk/>

Hapi 6**Dorëzimi i biznes idesë të
përpiluar personalisht**

Për qëllime të Programit për Vetëpunësim, AMSRM publikon Thirrje publike për të gjitha fondacionet për mbështetjen e sipërmarrjes dhe ekonomisë së vogël (Qendrat Rajonale dhe QP-të e Agjencisë). AMSRM-ja gjithashtu publikon thirrje publike për përzgjedhjen dhe pranimin e këshilltarëve në Katalogun e këshilltarëve pranë AMSRM-së, si dhe thirrje për të gjithë këshilltarët dhe ekspertët të autorizuar të cilët tashmë janë të evidentuar në Katalogun e AMSRM-së për pjesëmarrje në Programin për Vetëpunësim.

Mbështetje këshillimore përmes sistemit të këshillimit Vauçer të AMSRM-së, për të cilin ekziston një Program i zhvilluar posaçërisht, i disponueshëm në linkun e mëposhtëm: file:///C:/Users/Com/Downloads/PROGRAMA%20za%20vauçersko%20sovetuvanje_REZIME.pdf

Dokumentet e nevojshme i gjeni në këtë link:
<http://www.apprm.gov.mk/VoucherDocuments>

Pjesëmarrja e AMSRM -së në Programin për Vetëpunësim fillon me marrjen e listës përfundimtare të kandidatëve që vazhdojnë në fazën e këshillimit me kupon, gjegjësisht zhvillimin e një plani të qëndrueshëm biznesi. Më pas AMSRM-ja, përgatit një plan për lidhje ndërmjet kandidatëve dhe këshilltarëve të përzgjedhur, që do të zhvillohet në qendrat përkatëse të punësimit.

Hapi 7

Përzgjedhje e biznes ideve më të mira

Hapi i shtatë është përzgjedhja e biznes ideve më të mira, të cilat bëhen sipas Kriteve për evaluim (vlerësim) të një ideje biznesi (shih Shtojca nr.3) me një maksimum prej 50 pikësh.

Pasi kalohet ky hap, kalohet në fazën e krijimit të biznes planit.

Hapi 8

Pjesëmarrja në zhvillimin e biznes planit me mbështetje këshilluese nga një këshilltar i AMSRM-së

Ky hap gjithashtu përfshin edhe mentorim. Pas përzgjedhjes fillestare të pjesëmarrësve, çdo kandidati do t'i sigurohet mentor i cili do të bashkëpunojë intensivisht dhe do ta këshillojë pjesëmarrësin/en në program, gjatë 12 muajve. Roli i mentorit/es do të konsistojë në ofrimin e një qasjeje individuale gjatë të gjithë procesit, dhe veçanërisht për motivimin dhe mbështetjen e tyre psiko-sociale.

Pas trajnimeve, mentori/ja do të japë mendim në lidhje me predispozitat e kandidatëve për fillimin e biznesit të tyre. Ky opinion do të merret parasysh nga Komisioni për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në program gjatë vlerësimit të bizneseve.

Në kuadër të PO 2022, Aplikimet me të gjithë formularët dhe dokumentacionin shoqëruar dorëzohen personalisht ose me postë të regjistruar në Qendrat Rajonale të listuara më poshtë, me shënim: Kërkesë për thirrje publike për shërbime mentorimi në vitin 2022.

Hapi 9**Plotësimi dhe nënshkrimi i
Deklaratës për pëlqim**

Hapi tjetër është plotësimi dhe nënshkrimi i një dokumenti zyrtar të titulluar Deklarata për pëlqim (shih Shtojcën 2), në të cilin janë përcaktuar qartë aktivitetet në të cilat kandidatet duhet të marrin pjesë, si dhe detyrimet me të cilat obligohen me përfshirjen në masën përmes nënshkrimit të kësaj Deklarate.

Qendra Rajonale Shkup

Fondacioni për zhvillimin e ndër-
marrjeve të vogla dhe të mesme

rr. Partizanski Odredi 17, hyrja 3 (kat
i ndërmjetëm), 1000 Shkup

email: recs@recs.org.mk

Personat kontakt:

Svetlana Kirevska
svetlanakirevska@gmail.com
070 720 580

Evgenija Lisi[ova
e.lisichova@gmail.com
071 530 548

Qendra Rajonale Veles

Fondacioni për mbështetjen e ndër-
marrjeve të vogla dhe të mesme

rr. Dimitar Vahov 27, 1400, Veles

email: rcve@t.mk

Personat kontakt:

Anita Samarxhieva
rcve@t.mk
075 236 667

Qendra Rajonale Manastir

Fondacioni për zhvillimin e sipër-
marrjes, bashkëpunimit rajonal dhe
ndërkufitar

Blvd. 1 maj pn, 7000 Manastir

email: rcbt@t.mk

Personat kontakt:

Nikolla Dimkovski
regiobt.mk@gmail.com
070 997 084

Milena Dimkovska
milena.p.mkd@gmail.com
071 464 950

Qendra Rajonale Strumicë

Fondacioni për Zhvillimin e Ndër-
marrjeve të Vogla dhe të Mesme

rr. 11 Tetor pn (bllok 87), 2400
Strumicë

email: rcsr@t.mk

Personat kontakt:

Marija Tasheva
rcsr@t.mk
071 201 068

Vaska Kostadinova vaska_taseva@
yahoo.com
078 806 150

Verica Çorev
verica.chorev@yahoo.com
077 983 943

Qendra Rajonale Kumanovë

Fondacioni për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme

rr. Ilindenska pn, kati 3, (ish Komiteti)
1300 Kumanovë

email: razvojku@mt.net.mk

Personat kontakt:

Igor Georgiev
eurokiwi@t.mk
075 651 790

Sasho Velkovski
sasovelkovskisv@gmail.com
071 208 977

ESA Tetovë

Fondacioni për Mbështetjen e Ndërmarrjeve

Bulevar Turisticka pn (faks 129),
6000 Ohër-

email: esate@t.mk

Personat kontakt:

Nebi Jusufi,
esate@t.mk
070 329 256

Salajdin Idrizi
esate@t.mk
070 224 005

ESA Ohër

Fondacioni për Mbështetjen e Ndërmarrjeve

Bulevar Turisticka pn (faks 129),
6000 Ohër-

email: esaoh@t.mk

Personat kontakt:

Mimoza Popovska
mpm_ds@t.mk
070 391 664

Toni Cvetanoski
tcvetanoski21@gmail.com
076 437 545

Formulari 1 - Aplikimi mund ta shkarkoni në linkun

Udhëzim për zbatimin e shërbimeve të standardizuara të mentorimit mund ta shkarkoni në linkun

Informata më të detajuara mund të merrni në qendrat rajonale të lartpërmendura ose në AMSRM në adresën e emailit: mentoring@apprm.gov.mk si dhe në faqen e internetit të AMSRM-së:

<http://www.apprm.gov.mk/Mentoring> dhe <https://www.facebook.com/mentoringmacedonia/>

Si pjesë e këtij hapi, plotësohet formulari Informacion mbi zgjedhjen e konsulentit nga AMSRM për zhvillimin e biznes planit (shih Shtojca nr. 4)

Hapi 9**Përzgjedhje e planeve më të mira të biznesit**

Përzgjedhja e planeve më të mira të biznesit bëhet pas një vlerësimi të të gjitha planeve të biznesit, të kryer nga Komisioni i Ekspertëve për Vlerësimin e Planeve të Biznesit (KEVPB) sipas kriterëve të miratuara (shih Aneksin 5).

Hapi 10**Regjistrimi i biznesit/subjektit juridik përmes
Regjistrimit Qendror të RM-së**

Pas rangimit dhe përzgjedhjes së PB-ve më të mira, qendrat e punësimit organizojnë seminare informative ku kandidatëve dhe mentorëve të tyre do t'u jepen këshilla për llojet e personave juridikë, dokumentet e kërkuara dhe hapat për regjistrimin e biznesit, si dhe cilat janë institucionet përkatëse të cilat duhet të kontaktojnë gjatë regjistrimit. Gjithashtu, sigurohet fletë informacioni me të gjithë informacionin e nevojshëm për regjistrimin e formave të ndryshme organizative të personave juridikë (shih Shtojcën 6).

Hapi 11**Nënshkrimi i Marrëveshjes për grant dhe prokurim të
pajisjeve dhe/ose materialeve**

Pas regjistrimit të kompanisë në përputhje me Ligjin për punësimin e personave me invaliditet, kandidati/ja dorëzon aplikacionin dhe dokumentet tjera mbështetëse për punësim në Qendrën përkatëse të Punësimit. Pas lidhjes së marrëveshjes për punësim, përfituesi/ja nënshkruan Marrëveshje për grant. Marrëveshja Standarde për Bashkëpunim nënshkruhet ndërmjet APRM-së, UNDP-së dhe Përdoruesit dhe është e vlefshme për një periudhë 24 muaj nga dita e nënshkrimit.

Nënshkrimi i marrëveshjeve do të bëhet duke iu referuar marrëveshjes nga sistemi i APRM-së.

Çfarë thonë përvojat?



Shumica e pjesëmarrëseve në grupet e fokusit, pavarësisht moshës, e vlerësuan të gjithë procesin e pjesëmarrjes në masën Vetëpunësim me grant - nga aplikimi deri në nënshkrimin e marrëveshjes ose deri në fazën deri te e cila kanë arritur si “shumë pozitive” dhe “në përgjithësi të mbështetur nga këshilltarët për masa aktive për punësim”. Qëndrimi i përgjithshëm i shumicës së pjesëmarrëseve në diskutimet në fokus grupet është se qendrat e punësimit, si institucione nga sistemi formal, ofrojnë mbështetje solide në procesin e vetëpunësimit dhe hapjes së biznesit.



Kam aplikuar në mënyrë të rregullt, në Qendrën e Punësimit në Manastir. Më thirrën në telefon, pasoi trajnimi... Aplikimi ishte i lehtë, i qartë, e plotësova shpejt

Pronare e biznesit individual që nga viti 2021,
30 години



Punonjësi plotësoi aplikacionin me përgjigjet e mia për pyetjet që më bënte... Kam pasur mbështetje të madhe nga punonjësit e Qendrës për punësim, me ndihmën e të cilëve arrita të realizoj një plan jete. Tani shpresoj që të vazhdojë si një histori suksesi...

Aplikante në Masën Vetëpunësim 2021,
35 vjeç



Në përgjithësi aplikacioni, ose më saktë pyetësi që u bëhet kandidatëve dhe kandidateve, ka pyetje të paqarta. Kjo bëhet për të vlerësuar shpirtin dhe aftësitë sipërmarrëse të aplikantit ose aplikantes. Si Këshilltare për masat aktive për punësim, ndihmoj gjithmonë ... edhe kolegët dhe koleget e mija në plotësimin e aplikacionit dhe pyetësorit. Jo se ne i dimë përgjigjet e sakta, nuk diskutohet! Këtu i udhëzojmë kandidatët dhe kandidate në përgjigjet, në pajtim me idetë dhe planet e tyre të biznesit...”

Këshilltare për masa aktive për punësim në
APRM-Qendra për punësim

Cilat janë PËRFITIMET për vajzat dhe gratë nga masa aktive për punësim: Programi për Vetëpunësim (Sipërmarrje) me grant?

Çfarë përfitojnë njerëzit (duke përfshirë vajzat dhe gratë) të përfshirë në Programin për Vetëpunësim?

Nëse vendosni t'i bashkoheni kësaj mase Programi për Vetëpunësim (Sipërmarrje) me grant, do të merrni përfitimet e mëposhtme:

- ✓ pjesëmarrja në trajnime online për sipërmarrje dhe përvetësimi i aftësive bazë për të kryer biznes dhe sipërmarrje (vetëm për personat me aftësi të kufizuara);
- ✓ certifikatë për trajnim të përfunduar nëse janë kryer të paktën 80% e numrit total të orëve të planifikuara të trajnimit dhe e njëjta do të jetë e vlefshme në ciklin e ardhshëm në vitin aktual;
- ✓ mbështetje në zhvillimin e një plani biznesi me këshilltarët e AMSRM-së;
- ✓ mbështetje për regjistrimin e subjektit juridik në Regjistrin Qendror të RMV-së;
- ✓ mbështetje gjatë themelimit të marrëdhënies së punës në personin juridik që e kanë regjistruar;
- ✓ mbështetje për vetëpunësim;
- ✓ grant - mjete në vlerë deri në 307.500 denarë (me TVSH) ose deri në 615.000 denarë (me TVSH) nëse personi juridik është i themeluar nga dy ortakë - SHPK në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshjen;
- ✓ mundësia për grant plotësues për punësimin e 1 personit në shumë prej 92.000 denarë sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje;
- ✓ mbështetje këshillimore/mentoruese për një periudhë 12 mujore nga themelimi i biznesit. Këtë të drejtë e kanë grupet e mëposhtme të synuara: personat me aftësi të kufizuara; anëtarë të komunitetit rom dhe gra nga kategoritë të rrezikuara (pranues të ndihmës sociale, viktimat të dhunës në familje, viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore, nëna të vetme dhe gra me përjashtuar social për shkak të tepërisë teknologjike dhe falimentimit).

Cilat janë të DREJTAT dhe DETYRIMET e vajzave dhe grave në masën aktive për e punësim: Programi për Vetëpunësim (Sipërmarrje) me grant?

Me pjesëmarrjen Tuaj në Programin për Vetëpunësim (Sipërmarrje) me grant fitoni të drejtat e mëposhtme, por edhe detyrimet që duhet të përmbushni:

1

Nëse, brenda ciklit të projektit, keni dorëzuar një plan biznesi që ka kaluar me sukses procesin e vlerësimit (plani i përzgjedhur i biznesit), ndërsa më pas tërhiqeni nga pjesëmarrja e mëtejshme, përpara se të përdorni fondet e grantit, nuk mund të ktheheni në evidencën e personave të papunë në APRM, për të paktën një vit, llogaritur nga dita e anulimit. Duke vepruar kështu, Ju duhet të plotësoni Deklaratë për ndërprerjen e pjesëmarrjes në program.

2

Si person juridik/përfitues/e i cili / e cila mbështetet në pajtim me këtë program, jeni të detyruar të përmbushni detyrimet ligjore për pagesën e pagës dhe kontributeve për të gjithë 24 muajt nga dita e themelimit të marrëdhënies së punës, përndryshe, jeni të detyruar të ktheni mjetet e paguara në tërësi.

3

Nëse si person juridik/përfitues mbështeteni sipas këtij programi, nëse pas skadimit të cilave do 6 (gjashtë) muaj radhazi brenda 2 viteve nga regjistrimi i biznesit Tuaj nuk keni paguar pagë bruto përmes Drejtorisë së të Ardhurave Publike, do të merrni letër paralajmëruese për mos aktivitet financiar të kompanisë nga Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nëse pas kalimit të 2 (dy) muajve nga dita e dorëzimit të paralajmërimit, ju si person juridik/përfitues i grantit vazhdoni me mos-pagesë të pagës bruto, Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut fillon procedurë për kthimin e të gjithë shumës së mjeteve të paguara në bazë të Marrëveshjes që keni lidhur/nënshkruar (100% e mjeteve financiare të paguara).

4

Nëse punësimi Juaj si përdoruese dhe themeluese e kompanisë përfundon para skadimit të 2 viteve nga data e punësimit, për shkak të punësimit tjetër, në vendin Tuaj duhet të punësoni menjëherë një person tjetër nga evidenca e personave të papunë në APRMV-së, punësimi i të cilit duhet të zgjasë së paku deri në përfundim të kohëzgjatjes së marrëveshjes. Përndryshe, jeni të detyruar të ktheni mjetet e paguara. Për të realizuar sa më sipër, duhet të paraqisni Kërkesë, për të cilën vendos Komisioni për përzgjedhjen e pjesëmarrësve për masat aktive për punësim.

5

Nëse si person juridik/përfitues dhe themelues i shoqërisë brenda 2 viteve nga regjistrimi si person juridik ju ndërpret aktivitetin ose nëse si përfitues i grantit ju ndërpritet punësimi për ndonjë arsye (përveç në rast të paaftësisë për punë ose vdekjes) në afat prej 2 vjet nga lidhja e marrëdhënies së punës, ndërsa gjatë kësaj Kërkesa për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nuk është miratuar para skadimit të 2 viteve nga data e punësimit dhe për qëllime të një punësimi tjetër, në përputhje me procedurën e përshkruar në këto udhëzime, Ju si themeluese/përfituese e grantit jeni të detyruar të ktheni:

- 80% të grantit nëse ndërprerja ndodh është në vitin e parë të regjistrimit të personit juridik; ose
- 60% e grantit nëse ndërprerja është në vitin e dytë të regjistrimit të personit juridik.

6

Nëse ju, si themeluese/përfituese e një granti, ndaloni së ushtruar aktivitetin tuaj, nuk mund të ktheheni në evidencën e personave të papunë brenda 3 viteve nga dita e themelimit të marrëdhënies së punës.

7

Nëse jeni person juridik i themeluar nga një person me aftësi të kufizuar që punëson një person shtesë në kuadër të këtij programi, atëherë jeni i detyruar ta punësoni personin me kohë të plotë dhe ta mbani në punë për të paktën 12 muaj nëse është person nën 29 vjeç, përkatësisht 9 muaj nëse është person mbi 29 vjeç.

Nëse për kohëzgjatjen e periudhës së detyrimit të përcaktuar ndërpritet marrëdhënia e punës e personave të tjerë të punësuar, përveç rasteve kur shkakët e ndërprerjes së marrëdhënies së punës janë vdekja ose paaftësia për punë, ju si punëdhënës keni detyrimin të punësoni një person tjetër të papunë të regjistruar në APRMV ose t'i ktheni mjetet në një shumë të barabartë me detyrimin e parealizuar për numrin e reduktuar të punonjësve.

8

Të drejtat dhe detyrimet më të detajuara janë rregulluar më hollësisht në marrëveshjen e grantit, që nënshkruhet para ndarjes së mjeteve.

MBËSHTETJE PËR VETËPUNËSIM (SIPËRMARRJE) - “Vetëpunësim me kredi” (rimbursime për fillimin e biznesit individual)

- **Qëllimi** i Projektit është që personat e interesuar të papunë, punëkërkuar aktivë që duan të hapin biznesin e tyre, të kenë kredi të favorshme, të cilat do të hapin vende të reja pune dhe do të vetëpunësohen në fushën e bujqësisë, tregtisë, industrisë përpunuese, ndërtimit, veprimtarive shërbyese etj.
- **Mbështetja financiare** konsiston në sigurimin e mjeteve të kthyeshme-kredi nga të paktën 5000 euro deri në maksimumi 10.000 euro, sipas zgjedhjes së aplikantit/aplikantes dhe për çdo vend pune të sapo hapur 5000 euro shtesë, ndërsa financohen projektet me maksimum 5 vende pune (duke përfshirë edhe kreditorin), përkatësisht deri në 30000 euro, pavarësisht nëse bëhet fjalë për veprimtari me kapacitet të madhe ose të vogël.

Udhëzime për vajzat dhe gratë - Cilat janë hapat në realizimin e VETËPUNËSIMIT - me kredite?



Hapi 1

Thirrje publike

Si për masën Vetëpunësim me grant, ashtu edhe në këtë masë fillimisht është i nevojshëm njoftimi zyrtar ose thirrje publike për aplikim për masën. Thirrja publike publikohet në ueb-faqet zyrtare të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale. (www.avrm.gov.mk; www.mtsp.gov.mk, si dhe në faqen e specializuar të internetit www.rabotaimoznosti.mk).

Gjithashtu, shpallja në formë të shkruar mund të gjendet në tabelat e shpalljeve në 30 qendrat e punësimit të APRM-së në gjithë Republikën e Maqedonisë, si dhe në vende të tjera përkatëse nëpër institucionet në nivel lokal (komuna, QPS dhe vende të tjera që frekuentohen më shumë).

Shpallja është e vazhdueshme/e hapur gjatë gjithë vitit, deri në plotësimin e numrit të parashikuar të aplikantëve. Thirrja publike për masën Sipërmarrje – Vetëpunësim me kredi, 2022 është publikuar më 03.08.2022 dhe gjendet në linkun e mëposhtëm:

<http://av.gov.mk/>

Hapi 2

Aplikimi - paraqitja e kërkesës

Në varësi të shumës së kredisë së kërkuar, paraqitet:

- ✓ Kërkesa për dhënie kredie (3000 euro) – shih Shtojcën nr. 7
- ✓ Kërkesë për dhënie kredie (5000 euro) – shih Shtojcën nr. 8

Kërkesa për kredi mund të dorëzohet në klubet e punës të 30 Qendrave për Punësim të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri në ora 14:00, ku mund të merrni informacion më të detajuar për projektin.

Personat e papunë mund të aplikojnë edhe elektronikisht përmes sistemit e-Punë <https://e-rabota.av.gov.mk>.

Hapi 3

Kur aplikoni, është e nevojshme të paraqisni një mini plan biznesi. Ud-hëzimet për krijimin e një plani biznesi, së bashku me dokumentin Mini biznes plan, gjenden në linkun e mëposhtëm: http://av.gov.mk/info-ns_article-obrazec-kreditiranje.nsp

Hapi 4

Hapi i fundit drejt zbatimit të kësaj mase është miratimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet aplikantit/es dhe APRMV-së.

> Përfitimet nga përdorimi i masës

- ✓ Periudha e shlyerjes është 7 vjet, duke përfshirë grejs periudhë prej 1.5 vjetësh, pavarësisht nga shuma e kredisë.
- ✓ Norma e interesit prej 1% në nivel vjetor.
- ✓ Pjesëmarrje perspmale nga përfituesi i kredisë prej të paktën 25% të shumës së kredisë së kërkuar (në formën e pajisjeve, objekteve dhe/ose parave).
- ✓ Garanci për kthimin e mjeteve me hipotekë në raportin 1:1 me kredinë e miratuar, ose kambial të vërtetuar nga të paktën një garantues për të cilin të drejtat dhe detyrimet në lidhje me të njëjtën rregullohen me kambial të dhënë në formën e aktit noterial dhe me klauzolë ekzekutive ose garanci me shkrim në raportin 1:2 në shumën e kredisë së miratuar.

Çfarë thonë përvojat?



Nga përvojat e ndara në fokus grupet, është indikative gjetja se ka informim të dobët për këtë masë tek punëkërkuesit aktivë përmes vetëpunësimit, por edhe shumë pak interes për përfshirjen e vajzave dhe grave të papuna në të.

”

Personalisht, nuk jam shumë i informuar për masën, por realisht, nëse mund të përdor fonde të pakthyeshme, pse duhet të përcaktohem për kredi? Për mjetet që duhet të kthej? Nuk e di, ndoshta nuk jam mjaft e informuar... Por për mua kredia nuk është një masë e mirë...

Pronare e biznesit individual
që nga viti 2021, 43 години

”

Kjo nuk është një masë shumë popullore, për fat të keq, por për mendimin tim është një masë shumë e mirë. Sidomos për sipërmarrës në kuptimin e vërtetë të fjalës. Mundëson mjete financiare, jo në pajisje siç është rasti me masën e Vetëpunësimit me grant, por mjetet mund të përdoren për shpenzime të tjera, përfshirë pagat. Dhe është e favorshme, shumë më e favorshme se ajo që ofrojnë bankat...interesi është vetëm 1%...

Këshilltare për masa aktive
për punësim në APRM-Qendra
për punësim

3

**SHËRBIME DHE
MBËSHTETJE
JOQEVERITARE OSE
JOFORMALE PËR
VAJZAT DHE GRATË PËR
VETËPUNËSIM OSE
FILLIMIN E BIZNESIT
INDIVIDUAL**

Në pjesën e shërbimeve shtetërore apo formale dhe mbështetjes për vajzat dhe gratë për vetëpunësim apo fillimin e biznesit të tyre përmendëm organizatën ndërkombëtare UNDP dhe shoqatën e qytetarëve REDI.

Edhe pse nuk janë institucione shtetërore, megjithatë formalisht janë pjesë e Planit operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2022. Në Republikën e Maqedonisë, ndonëse nuk janë mjaftueshëm të dukshme dhe nuk ka shumë vetëdije për ekzistencën e tyre, ende ekzistojnë shërbime dhe mbështetje jo-shtetërore ose joformale për vajzat dhe gratë për vetëpunësim ose fillimin e biznesit individual, në formë të trajnimeve, mbështetje mentoruese, përfaqësim dhe informim të cilët janë në dispozicionin Tuaj dhe mund t'ju ndihmojnë për t'ju inkurajuar, por edhe për të realizuar dëshirën dhe/ose ëndrrën tuaj për të gjetur punë nëpërmjet vetëpunësimit ose biznesit individual. Këtu keni një listë dhe lidhje/linqe me disa prej këtyre burimeve të mbështetjes që mund të jenë të dobishme për Ju:

Platforma Nacionale për Sipërmarrjen e Grave

www.weplatform.mk



Koalicioni rural

<https://rural.mk/>



Qendra për Menaxhim me Ndryshime - QMN

<https://cup.org.mk/>




Maqedonia 2025

<https://www.macedonia2025.com/>



Fondacioni zhvillimor i Maqedonisë për ndërmarrje

<http://www.mrfp.mk/>



**Fondacioni për Shërbim
Sipërmarrës për të Rinjtë (FShSR)**

<http://www.yes.org.mk/>



**Fondacioni për Menaxhment dhe
Kërkim Industrial**

<http://www.mir.org.mk>



**Shoqata për mundësi të
barabarta- Rrjeti Stella
Rrjeti i Grave për Mentorim**

<http://www.stella.mk>



SHTOJCAT⁹

SHTOJCA NR. 1: Thirrje publike – Programi 1 Mbështetje për Vetëpunësim (Sipërmarrje)

ШАНСА ЗА СИТЕ



АГЕНЦИЈА ЗА ВРАБОТУВАЊЕ
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Nëse jeni person me vizion për biznesin tuaj, motiv për “zot i vetes”, energji për të luftuar sfidat, atëherë kjo Thirrje është pikërisht për Ju.

Lexoni dhe mësoni më shumë për mundësinë për të përfituar ndihmë financiare të pakthyeshme prej 5.000 deri në 10.000 euro nga Buxheti i Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të themeloni biznesin tuaj.

Për të gjitha pyetjet shitesë, Ju presim të vini në Qendrën e Punësimit dhe të shihni se për çfarë bëhet fjalë!

Bazuar në Planin Operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për 2022 vjet, miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për Programin 1. Mbështetje për Vetëpunësim (Sipërmarrje), financuar nga Buxheti i Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 05.04.2022 vitin e 2-të publikohet

THIRRJE PUBLIKE për personat e papunë

2. Personat e papunë me frymë sipërmarrëse, me vizion për të krijuar biznes individual, inkurajohen të aplikojnë në Programin Mbështetje për Vetëpunësim (Sipërmarrje).

Ftohen:

- Të rinjtë e papunë deri në 29 vjeç
- Personat e papunë me aftësi të kufizuara
- Personat e papunë – meshkuj deri në 60 vjeç dhe femra deri në 58 vjeç
- Gra-viktima të dhunës me bazë gjinore dhe viktima të dhunës në familje
- Personat e papunë që duan të formalizojnë biznesin e tyre - meshkuj deri në 60 vjeç dhe femra deri në 58 vjeç
- Personat e papunë – romë meshkuj deri në 60 vjeç dhe femra deri në 58 vjeç
- Personat e papunë për shkak të koronavirusit - meshkuj deri në 60 vjeç dhe femra deri në 58 vjeç
- Personat e papunë që janë kthyer nga jashtë shteti - meshkuj deri në 60 vjeç dhe femra deri në 58 vjeç

⁹ Të gjitha shtojcat e dhëna në këtë doracak mund të gjenden në faqen e internetit të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë (APRM) në gjuhën maqedonase: <http://av.gov.mk/> dhe gjuhën shqipe <http://av.gov.mk/shtepi.nspk>

¹⁰ Fokusi do të jetë te të kthyerit nga jashtë shtetit, pjesëtarët e komunitetit rom dhe personat e tjerë të rrezikuar nga përjashtimi social dhe ekonomik, të cilët janë ndër të kthyerit e mundshëm në të ardhmen në komunat Shuto Orizarë, Shtip dhe Prilep. Nëpërmjet projektit do të financohet krijimi i 9 bizneseve të reja.

të cilët duan të zgjidhin punësimin e tyre me mbështetje financiare përmes Programit për Mbështetjen e Vetëpunësimit (Sipërmarrje), të regjistrohen në klubet e punës të qendrave për punësim të APRMV-së, për të aplikuar për pjesëmarrje në program

3. Programi Mbështetje për Vetëpunësim (Sipërmarrje) ofron:

- sistem kupon për krijimin e një plani biznesi dhe mbështetje gjatë regjistrimit të biznesit;
- mjete të pakthyeshme (grant) në shumë prej 307.500 denarë për përdorues ose deri në 615.000 denarë nëse një person juridik është themeluar nga dy ortakë si SHPK - Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nga dy persona, ku secili prej ortakëve do të ketë pjesë të barabartë (50%) në shoqëri. Nëse njëri nga personat që aplikojnë për SHPK refuzon të marrë pjesë në masë, në çdo fazë të zbatimit të masës, tjetrit i hiqet njëkohësisht e drejta për të marrë pjesë.
- granti që do të pranohet në një llogari të dedikuar (në pajtim me Udhëzimet operative) duke dorëzuar faturat e blerjes sipas planit të biznesit
- mbështetje financiare për punësim shtesë për bizneset e themeluara nga personat me aftësi të kufizuar
- mbështetje këshilluese/mentoruese gjatë një periudhe prej 12 muaj që nga themelimi i biznesit, do t'u ofrohet grupeve të synuara në vijim:
- o persona me aftësi të kufizuar;
- o anëtarët e komunitetit rom;

nga kategoritë e rrezikuara (përfutuese të ndihmës sociale, viktimat të dhunës në familje, viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore, nëna të vetme dhe gra me përjashtim social për shkak të tepricës teknologjike dhe falimentimit).

4. Personat e interesuar për të marrë pjesë në Program mund të aplikojnë deri më 15.04.2022 vite

5. Personat që kanë marrë një grant për Vetëpunësim në vitet e kaluara, nuk kanë të drejtë të aplikojnë për pjesëmarrje në Program.

6. Programi nuk do të mbështesë themelimin e bizneseve në veprimtaritë e mëposhtme :

- Veprimtari bujqësore, përkatësisht veprimtari nga Sektori A/A, Departamenti 01
- Prodhim bimor dhe shtazor, gjueti dhe veprimtaritë e shërbimit që lidhen me to, me përjashtim të prodhimit bujqësor organik;
- Bizneset në veprimtaritë e klasës 49.32 - Shërbimi taksit;
- Prodhimi dhe shpërndarja e armëve, përkatësisht veprimtaria e klasës 25.40
- Prodhimi i armëve dhe municionit;
- Bizneset financiare dhe të sigurimit dhe aktivitetet që përfshijnë lojërat e fatit, përkatësisht veprimtari nga Sektori K/I – Aktivitete financiare dhe aktivitetet e sigurimit.

Me përjashtim të Pikës 1 dhe 2, personat e papunë me aftësi të kufizuara, përfutues të garancisë asistencë minimale, personat që kanë humbur punën për shkak të Kovid-19 (që nga muaji mars 2020) dhe romët e papunë do të mund të regjistrojnë subjekt juridik në veprimtarinë bujqësore dhe shërbim taksit.

7. E drejta për pjesëmarrje përcaktohet në bazë të kushteve dhe kritereve të përcaktuara për çdo program individual, gjegjësisht masë punësimi, si dhe në bazë të parimeve bazë që duhen respektuar gjatë zbatimit të programeve dhe masave për punësim, si dhe shërbimet në tregun e punës, përkatësisht

- Bafalaqimi me efektet dhe pasojat negative mbi tregun e punës dhe punësimin të shkaktuar nga pandemia KOVID-19;
- Parimi i diversitetit dhe gjithëpërfshirjes për të gjitha kategoritë sociale në sektorin privat në përputhje me parimet e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të qytetarëve sipas përkatësisë etnike, gjinore, fetare, racës apo çdo kategori tjetër të cënueshme të qytetarëve në përputhje me standardet dhe praktikën e Kombeve të Bashkuara dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës;
- Inkurajimi i zhvillimit të barabartë rajonal, në përputhje me të dhënat e Byrosë për zhvillim rajonal dhe shkallën e zhvillimit të rajoneve planore në Republikën e Maqedonisë së Veriut

8. Të drejtat dhe detyrimet ndërmjet APRMV-së dhe pjesëmarrësve në program do të rregullohen me lidhjen e një marrëveshjeje reciproke.

Aplikimi për pjesëmarrje duhet të dorëzohet në klubin e punës në qendrat e punësimin, çdo ditë pune nga ora 08:00-14:00. Të gjithë të interesuarit mund të marrin informacione të detajuara për masën në klubet e punës të 30 Qendrave për Punësim të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në qendrën e kontaktit 02-3111-850 dhe në faqet e internetit www.av.gov.mk dhe www.rabotaimoznosti.mk.

**AGJENCIA PËR PUNËSIM E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

SHTOJCA NR. 2: Deklaratë për pëlqim – Programi Vetëpunësim

Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë
Qendra për Punësim _____

Deklaratë

Nga _____ me NVAQ _____ nga _____
_____ me vendbanim të përhershëm në adresën _____
_____ nr. _____.

Deklaroj se nuk jam themelues apo menaxher i një shoqërie të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë dhe pajtohem të përjashtohem nga programi nëse vërtetohet e kundërta. Gjithashtu pranoj që të dhënat e mia personale të përdoren për mbajtjen e të dhënave të nevojshme në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Pajtohem të përfshihem në aktivitete të mëtejshme të ofruara nga Programi Vetëpunësim, nëpërmjet:

- trajnimit për sipërmarrësi dhe menaxhim biznesi;
- mbulimin e shpenzimeve për regjistrim të firmës;
- mbulimin e shpenzimeve për blerjen e pajisjeve dhe/ose materialeve për fillimin e biznesit;

Pajtohem:

- të marr pjesë në trajnime në fushën e sipërmarrësisë;
- të marr pjesë në zbatimin e të gjithë hapave të parashikuar nga programi;
- nëse heq dorë nga e drejta e përdorimit të grantit në përputhje me kushtet e Programit për Vetëpunësim, të shlyhem nga evidenca e personave të papunë për kohëzgjatje prej një (1) vit sipas Ligjit për punësim dhe sigurim në rast papunësie;
- nëse heq dorë pas regjistrimit të firmës dhe themelimit të marrëdhënies së punës, gjegjësisht vetëpunësimit dhe mjetet nga granti i shfrytëzoj në përputhje me Marrëveshjen për grant, në dy (2) vitet e ardhshme të mos mund të kthehem në evidencën e personave të papunë;
- nëse e ndërpres ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë para skadimit të një (1) ose dy (2) vjetësh nga data e regjistrimit të biznesit, të kthej në periudhë prej 12 muajsh:
 - o 80% të mjeteve financiare të përdorura për blerjen e pajisjeve dhe/ose materialeve, përkatësisht
 - o 60% të mjeteve financiare nëse ndërpres ushtrimin e veprimtarisë para skadimit të dy (2) viteve nga data e regjistrimit të biznesit;
- nëse pas regjistrimit të kompanisë jam financiarisht joaktiv, përkatësisht kam detyrime të papaguara ndaj DAP-së për çdo 3 (tre) muaj rresht dhe nuk veproj sipas paralajmërimit nga APRMV-së, për të kthyer shumën e mjeteve financiare.

Data _____
Në _____

Deklaroi,

SHTOJCA NR. 3:

Kriteret për vlerësimin e një ideje biznesi (maksimumi 50 pikë)

	KRITERET	PIKAT MAKS.	SHPJEGIM	VLERËSUES
1	TREGU (produkti/tregu dhe konkurrenca)	20		EKOBP
	Produkt/Tregu	15	Një produkt dhe treg i përshkruar mirë vlerësohet me maksimum prej 15 pikësh. Nëse pjesëmarrësi nuk ka përshkrim të mirë dhe nuk ka njohuri të mjaftueshme për produktin/shërbimin që shet, si dhe për tregun ku operon (blerësit, furnitorët, kanalet e shpërndarjes, përkatësisht 4 P-të), atëherë vlerësohet me më pak pikë).	EKOBP
	Përshkrim i mirë i produktit/shërbimit	5-7		
	Përshkrimi më pak i mirë i produktit/shërbimit	2-4		
	Përshkrimi i dobët i produktit/shërbimit	0-1		
	Njohuri shumë të mira të tregut	6-8	Tregu vlerësohet me maksimum 8 pikë. Shembull i mosnjohjes së tregut: e shes produktin tim në fshatin ose rrethinën time (ndërsa në fakt shet me shumicë ose eksporton)	EKOBP
	Njohuri të pjesshme të tregut	3-5		
	Njohuri bazë për tregun	2		
	Mosnjohje e tregut	0		
	Konkurrencë	5	Konkurrenca vlerësohet veçmas. Sa më mirë pjesëmarrësi të njohë blerësit/konkurrencën e tregut në të cilin operon, ai merr pikë më të larta, në të kundërt vlerësohet me më pak ose 0 pikë.	EKOBP
	Blerësit	0-3		
	Konkurrentët	0-2		

	KRITERET	PIKAT MAKS.	SHPJEGIM	VLERËSUES
2	Përvojë	10		APRMV
	Përvojë	5	Gjatë vlerësimit të përvojës, duhet të vlerësohet përvoja e përgjithshme formale dhe joformale e punës; dhe	APRMV
	Përvojë pune mbi 10 vjet	2		
	Përvojë pune deri në 10 vjet	1		
	Pa përvojë pune	0		
	Përvojë në aktivitetin mbi 10 vjet	3	Përvojë në veprimtarinë (në lidhje me biznesin e planifikuar), përvojë në prodhim, shitje dhe mbi të gjitha në drejtimin e biznesit apo në ndonjë funksion tjetër drejtues etj.	APRMV
	Përvojë në veprimtarinë 5-10 vjet	2		
	Përvojë në veprimtari deri në 5 vjet	2		
	Pa përvojë	0		
	Njohuri	5	Njohuritë vlerësohen nga pikëpamja e njohurive teorike dhe teknike të punës që do të ushtrojë, të fituara qoftë përmes sistemit arsimor, trajnimeve shtesë apo përvetësim-it plotësues (seminare, kurse, etj.)	APRMV
	Arsim të lartë/sipëror	3		
	Të mesëm	2		
	Fillor	1		
	Seminare dhe trajnime	2		

	KRITERET	PIKAT MAKS.	SHPJEGIM	VLERËSUES
3	INVESTIM	3		APRMV
	Shuma e mjeteve financiare	3	Investimi total përfshin mjetet e siguruar përmes grantit. Vlerësimi i investimit bëhet për sa i përket lartesisë së investimit dhe sa realist është ai në raport me biznesin të cilit i referohet. Për shembull, nëse shuma e investimit është 10.000 euro për të filluar prodhimin e tekstilit, është e qartë se shuma e mjeteve financiare shprehet në mënyrë jo reale dhe vlerësohet me më pak pikë. Nëse kjo nuk përshkruhet qartë në idenë e biznesit, zbulohet përmes bisedës.	APRMV
	Mbi 6.000 euro	3		
	Nga 3.000 deri në 6.000 euro	2		
	Deri në 3.000 euro	1		
	Mjetet e siguruar (depozitë personale)	2	Vlerësohet mbulimi i investimit dhe realiteti i burimeve të përcaktuara të mjeteve financiare. Sa është pjesa e grantit në investimin dhe nëse ka burime të tjera reale të kapitalit. Për konstrukcion financiar më realist të mbyllur, vlerësim më i lartë. Për shembull, nëse investimi përmban 10% grant dhe 90% kredi, ai konsiderohet joreal, sepse është pothuajse e pamundur të marrësh kredi për një biznes fillestar. Gjithashtu nëse investimi mbështetet në mjete të huazuara, vlerësohet me pikë më të ulëta.	APRMV
	Janë siguruar mbi 50%	2		
	Janë siguruar 1% deri në 50%	1		
	Mjete të pasiguruara	0		

	KRITERET	PIKAT MAKS.	SHPJEGIM	VLERËSUES
4	FITIMI DHE FINANCAT	15		EKOBP
	Financa	5	Vlerësohet nëse shpenzimet dhe të ardhurat e pritshme nga shitja ose shërbimi janë vlerësuar realisht. Nëse kandidati tregon njohuri shumë të mira për planin financiar që duhet të jetë realist, fiton pikë maksimale, në të kundërt të paktën 1 pikë.	EKOBP
	Njohuri të shkëlqyera	2		
	Njohuri solide	1		
	Njohuri e dobët	0		
	Rentabiliteti	3	Rentabiliteti nuk është një kriter eliminues. Nëse tregohet se biznesi është jofitimprurës në fazën fillestare të ekzistencës së tij, do të vlerësohet me minimum 1 pikë. Rentabiliteti i lartë dhe vlera e lartë e shtuar vlerësohen me një rezultat të lartë.	EKOBP
	Fitim mbi 30%	2		
	Fitim prej 15% në 30%	2		
	Fitimi më pak se 15%	2		
	Humbje	1		
	Punësime shtesë	2	Në varësi të llojit të idesë së biznesit që do të vlerësohet ose bazuar në një deklaratë për të vlerësuar kriterin. Disa persona juridikë si rregull duhet të kenë të paktën një punonjës tjetër në kompani. Nëse punësimi shtesë është i specifikuar në BI/BP, ai duhet të arsyetohet mirë dhe të korrespondojë me shpenzimet fikse për pagë.	APRMV
	1 punësim shtesë dhe më shumë	2		
	Vetëpunësim	1		

	KRITERET	PIKAT MAKS.	SHPJEGIM	VLERËSUES
5	CILËSIA E ANALIZËS SWOT	5		EKOBP
	Analizë e bërë shumë mirë	5	Të vlerësojë se sa kandidati është i vetëdijshëm për pikat e forta dhe të dobëta të idesë së tij të biznesit, por edhe nëse i njeh kërcënimet dhe mundësitë që sjell mjedisi.	EKOBP
	Analizë e përpunuar mirë	3		
	Analiza e punuar dobët	1		
6	Opinion nga Qendra e Punësimit: (me arsyetim të mirë)		PO rekomandohet	NUK rekomandohet

SHTOJCA NR. 4:

Informacion për zgjedhjen e një konsulenti nga APPRM për zhvillimin e një plani biznesi

Të nderuar,

Në lidhje me hapin tjetër të projektit Vetëpunësimi _____ vit, Ju informojmë për procedurën e zgjedhjes së konsulentit nga AMSRM (Agjencia për Mbështetjen e Sipërmarrësisë së Republikës së Maqedonisë).

Kandidati duhet të dërgojë një e-mail nga adresa e tij e-mail në samovrabortuvanje.mk@undp.org me të dhënat e mëposhtme:

Për: samovrabortuvanje.mk@undp.org

Tema: Qendra për Punësim (të shënohet nga cila Qendër Punësimi vjen kandidati).

Në përmbajtjen e mesazhit të shënohet:

Emri dhe mbiemri juaj

NVAQ (numri i vetëm amë)

Numri i telefonit (celular dhe fiks)

Nëse zgjidheni për të vazhduar në hapin tjetër, UNDP do t'ju dërgojë një fjalëkalim dhe udhëzime se si të identifikoheni në faqen e internetit të AMSRM-së dhe si të zgjidhni një konsulent.

SHTOJCA NR. 5:

Kriteret për vlerësimin e një plani biznesi (maksimumi 50 pikë)

	KRITERET	PIKAT MAKS.
1	TREGU (produkti/tregu dhe konkurrenca)	20
	Produkt/Tregu	15
	Përshkrim i mirë i produktit/shërbimit	5-7
	Përshkrimi më pak i mirë i produktit/shërbimit	2-4
	Përshkrimi i dobët i produktit/shërbimit	0-1
	Njohuri shumë të mira të tregut	6-8
	Njohuri të pjesshme të tregut	3-5
	Njohuri bazë për tregun	2
	Mosnjohje e tregut	0
	Konkurrencë	5
	Blerësit	0-3
	Konkurrentët	0-2
2	Përvojë	10
	Përvojë	5
	Работно Përvojë повеќе од 10 г.	2
	Përvojë pune deri në 10 vjet	1
	Pa përvojë pune	0
	Përvojë në aktivitetin mbi 10 vjet	3
	Përvojë në veprimtarinë 5-10 vjet	2

	Përvojë në veprimtari deri në 5 vjet	2
	Pa përvojë	0
	Njohuri	5
	Arsim të lartë/sipëror	3
	Të mesëm	2
	Fillor	1
	Seminare dhe trajnime	2
3	INVESTIM	3
	Shuma e mjeteve financiare	3
	Mbi 6.000 euro	3
	Nga 3.000 deri në 6.000 euro	2
	Deri në 3.000 euro	1
	Mjetet e siguruar (depozitë personale)	2
	Janë siguruar mbi 50%	2
	Janë siguruar 1% deri në 50%	1
	Mjete të pasiguruara	0
	Njohuri	5
	Arsim të lartë/sipëror	3
	Të mesëm	2
	Fillor	1
	Seminare dhe trajnime	2

4	FITIMI DHE FINANCAT	15
	Financa	5
	Njohuri të shkëlqyera	2
	Njohuri solide	1
	Njohuri e dobët	0
	Rentabiliteti	3
	Fitim mbi 30%	2
	Fitim prej 15% në 30%	2
	Fitimi më pak se 15%	2
	Humbje	1
	Punësime shtesë	2
	1 punësim shtesë dhe më shumë	2
	Vetëpunësim	1
5	CILËSIA E ANALIZËS SWOT	5
	Много добро разработена анализа	5
	Солидно разработена анализа	3
	Слабо разработена анализа	1

SHTOJCA NR. 6:

Fletë informative për regjistrimin e subjektit juridik

Ftohen kandidatët që kanë përfunduar me sukses të gjitha hapat e zbatimit të vijojnë me procedurën për regjistrimin e subjektit juridik dhe themelimin e punësimit. Në të njëjtën kohë, kandidatët duhet të marrin vendim se në cilën nga format e mundshme organizative ligjore do të regjistrohen (SHPKNJP, Tregtar individual ose Zejtari).

Regjistrimi i SHPKNJP ose Tregtar Individual:

Kandidatët të cilët, sipas veprimtarisë së biznesit të tyre, vendosin të regjistrojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me një person (SHPKNJP) ose tregtar individual (TI), regjistrimi duhet të kryhet në mënyrë elektronike nëpërmjet Agjentëve të Autorizuar për Regjistrim të Regjistrisë Qendror të R.M-së, të cilët gravitojnë në komunën përkatëse ose në komunën më të afërt.

Agjenti i Autorizuar për Regjistrim paraqet aplikimin për regjistrimin e themelimit të një SHPKNJP ose TI nëpërmjet Sistemit Qendror të Regjistrimit PA KOMPENSIM.

Nëse në një komunë ka më shumë se një agjent Regjistrues të autorizuar, përzgjedhja bëhet nga vetë kandidati. Procedura e regjistrimit në Regjistrinë Qendror bëhet përmes sistemit me një sportel.

Regjistrimi i ISHP-së:

Kandidatët që kanë miratimin për hapjen e një ISHP-je, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë e RM-së me vendim të Ministrisë regjistrohen në Regjistrinë Qendror në mënyrë të pavarur. Shpenzimet e regjistrimit të ISHP-së i mbulon Programi.

Regjistrimi i avokatit:

Regjistrimi i kandidatëve që kanë licencë avokatie bëhet nëpërmjet dhomës së avokatëve. Shpenzimet e regjistrimit të Avokatit i mbulon Programi.

Regjistrimi i zeztarit:

Kandidatët që ushtrojnë veprimtari zeztare regjistrohen në Regjistrinë Qendror nëpërmjet dhomës përkatëse zeztare të rajonit të cilit i përkasin. Më parë dhoma nxjerr vendim për regjistrim në regjistrinë e artizanëve.

Rekomandim:

Përpara fillimit të regjistrimit të personit juridik, klientët duhet të kontaktojnë qendrën përkatëse të punësimit për të marrë informacion të detajuar rreth mundësive të tjera të cilat janë në dispozicion përmes masave të tjera aktive për punësim nga APRM-ja.

Pas marrjes së vendimit nga Regjistri Qendror, çdo Përdorues është i detyruar të dërgojë një kopje në Qendrën përkatëse të Punësimit.

Lista e Agjentëve për Regjistrim mund të gjendet në tabelën e njoftimeve në qendrën përkatëse të punësimit dhe në faqen e internetit të Regjistrit Qendror <http://e-submit.crm.com.mk/eFiling/redefault.aspx>

SHTOJCA NR. 7:

Kërkesë për dhënie kredie sipas projektit për Vetëpunësim me kredi (Formulari B/1)

AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË Formulari B/1
QENDRA PËR PUNËSIM _____

Nr. i kërkesës _____ datë _____

KËRKESË PËR NDARJEN E KREDISË SIPAS PROJEKTIT PËR VETËPUNËSIM ME KREDI

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM RRETH KREDI KËRKUESIT

EMRI, EMRI I BABAIT DHE MBIEMRI _____
NVAQ _____
ADRESA _____ KOMUNA _____
NUMRI I TELEFONIT _____

2. INFORMACIONE TJERA PËR KREDI-KËRKUESIN (të plotësohet):

ARSIMI: _____
PROFESIONI: _____
PËR EVIDENCËN E PERSONAVE TË PAPUNË NË APRM NGA: _____
BAZA PËR NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIES SË PUNËS _____
PËRVOJË PUNE _____

3. SHUMA E KREDISË PËR TË CILËN DORËZON KËRKESËN (të rrumbullakohet)

a) 3.000 euro b) 6.000 euro c) 9.000 euro d) 1.000 euro shtesë për ____ persona
TOTALI: _____ euro

4. TË DHËNA PËR PROJEKTIN PËR TË CILIN KËRKOHEK KREDI:

4.1. VEPRIMTARIA: _____

IDE SPECIFIKE - EMRI I PROJEKTIT: _____

4.3. GARANCI (të rrumbullakohet)

a. HIPOTEKA

b. GARANTUESI

c. GARANCI E SHKRUAR

5. TË DHËNA PËR PERSONAT QË DO TË PUNËSOJË KREMAMARRËSI DHE NË EMRIN E TË CILIT PARAQET KËRKESËN PËR KREDI:

r.b.	Emri dhe mbiemri	NVAQ	Nënshkrimi
1			
2			
3			

SHTOJCA NR. 8:

Kërkesë për dhënie kredie sipas projektit për Vetëpunësim me kredi (Formulari B/2)

AGJENCIA PËR PUNËSIM E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË Formulari B/2

QENDRA PËR PUNËSIM _____

Nr. i kërkesës _____ datë _____

KËRKESË PËR NDARJEN E KREDISË SIPAS PROJEKTIT PËR VETËPUNËSIM ME KREDI

6. INFORMACION I PËRGJITHSHËM RRETH KËRKESËSIT

EMRI, EMRI I BABAIT DHE MBIEMRI _____

NVAQ _____

ADRESA _____ KOMUNA _____

NUMRI I TELEFONIT _____

7. INFORMACIONE TJERA PËR KREDI-KËRKUESIN (të plotësohet):

ARSIMI: _____

PROFESIONI: _____

PËR EVIDENCËN E PERSONAVE TË PAPUNË NË APRM NGA: _____

BAZA PËR NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIES SË PUNËS _____

PËRVOJË PUNE_____

8. SHUMA E KREDISË PËR TË CILËN DORËZON KËRKESËN (të rrumbullakohet)

a) 5.000 euro b) 8.000 euro c) 11.000 euro d) 14.000 euro e) 17.000 euro f) 1000 euro shtesë për ____ persona

TOTALI: _____ euro

9. TË DHËNA PËR PROJEKTIN PËR TË CILIN KËRKOHEK KREDI:

9.1. VEPRIMTARIA:_____

9.2. IDE SPECIFIKE - EMRI I PROJEKTIT: _____

9.3. GARANCI (të rrumbullakohet)

a. HIPOTEKA

b. GARANTUESI

c. GARANCI E SHKRUAR

10. TË DHËNA PËR PERSONAT QË DO TË PUNËSOJË KREMAMARRËSI DHE NË EMRIN E TË CILIT PARAQET KËRKESËN PËR KREDI:

r.b.	Emri dhe mbiemri	NVAQ	Nënshkrimi
1			
2			
3			
4			
5			

KREDIKËRKUESI,

BIBLIOGRAFIA DHE BURIMET

V. Abazi, E.B. Stavrevska 2021. Gratë sipërmarrëse në Maqedoninë e Veriut: Perceptimet dhe pengesat Shkup, Shoqata për Mundësi të Barabarta - Rrjeti Stella

Ligji për punësimin e personave me aftësi të kufizuara (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 44/2000, 16/2004, 62/2005, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 161/2008, 99/2009, 136/2011, 129/15 147/15, 27/16, 99/18, 103/21)

Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor - teksti i rishikuar (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 53/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18, 245/18, 180/19, 275/19, 31/20, 267/20)

Ligji për marrëdhënie pune - teksti i pastruar (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 167/15, 27/16, 120/18, 110/19, 267/20, 151/21)

Ligji për mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21, 294/21, 99/22)

Ligji për punësim dhe sigurim në rast papunësie - teksti i pastruar (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 112/14, 113/14, 56/15, 129/15, 147/15, 154/15, 27/16, 118/2016, 21/18, 113/18, 124/19, 103/21)

Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 258/20)

Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave - teksti i pastruar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 6/2012, 166/2014).

Plani operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2021, në dispozicion në <https://av.gov.mk/operativen-plan.nspix>

Plani operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2022, në dispozicion në <https://av.gov.mk/operativen-plan.nspix>

Udhëzimet operative për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime e tregun e punës nga Plan Operativ 2022

Raporti vjetor për vitin 2021, Shkup, APRM-së, në dispozicion në <https://av.gov.mk/godishni-izveshtai.nspx>

Enti Shtetëror i Statistikave, Baza e të Dhënave MakStat - Tregu i Punës, në dispozicion në <https://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef>

